



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 01 prot.

Kamëz, më 19.01.2021

V E N D I M

Nr. 01, datë 19.01.2021

PER

“PËR NJË NDRYSHIM NË VKB NR.51 DT 11.12.2019 “MBI PAGESËN E PLOTË TË QIRASË SIPAS VLERËS SË TREGUT PËR FAMILJET QË JANË DËMTUAR NGA TËRMETI I DATËS 26.11.2019”

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot më **19.01.2020** në kushte të veçanta si pasojë e masave të ndërmarra për parandalimin e përhapjes së virusit COVID-19 , pasi mori në shqyrtim **Projekt-Vendimin Nr.01 Datë 14.01.2021** , në mbështetje të nenit 8, nenit 2, nenit 29, nenit 54, neni 55, i Ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, të Ligjit nr.22/2018 “Për Strehimin Social”, Aktit Normativ Nr.8, datë 07.12.2019, të Këshillit të Ministrave”Për përdorimin e procedurës së përshpejtuar për subvencionin e pagesës së qirasë së banesës për familjet e mbetura të pastreha, si pasojë e fatkeqesisë natyrore,tërmetit të datës 26.11.2019” i ndryshuar me Aktin Normativ Nr.37, datë 24.12.2020, neni 7, Ligjit Nr.45/2019 “ Për Mbrotjen Civile” si dhe relacionit të Drejtorisë së Emergjencave Civile dhe Strehimit, **Këshilli Bashkiak Kamëz** :

V E N D O S I :

1. Të miratojë për vitin 2021 nivelin e qirasë mesatare mujore ne treg të lirë sipas strukturave të apartamenteve në territorin e Bashkisë Kamëz, si më poshtë:

Nr.	Emërtimi	Njësia	Nr.Frymësh	Sasia	Çmimi mesatar (lekë pa tvsh)
1	Banesa me qira (Apartament tip garsonierë)	muaj	1-2	1	13.000
2	Banesa me qira (Apartament 1 + 1)	muaj	3-4	1	18.000
3	Banesa me qira (Apartament 2 + 1)	muaj	5	1	21.000

4	Banesa me qira (Apartament 3 + 1)	muaj	6-8	1	24.000
---	--------------------------------------	------	-----	---	--------

2. Vlera maksimale e subvencionit të qirasë është e barasvlefshme me qiratë mesatare në tregun e lirë sipas vlerave të paraqitura në këtë Vendim.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Tiranë.

KRYETARE

MERITA PRENGA

